

TË DREJTAT E PACIENTIT *Patients' Bill of Rights*

Si një pacient i një spitali të Shtetit të Nju Jorkut,
Ju keni të drejtë, në përputhje me ligjin, që:

1. Të kuptoni dhe të përdorni këto të drejta. Nëse për ndonjë arsye nuk i kuptoni ose keni nevojë për ndihmë, Spitali DUHET të ofrojë ndihmë, duke përfshirë një interpretues.
2. Të merrni trajtim pa diskriminim race, ngjyre, besimi, seksi, origjine, paaftësie fizike, orientimi seksual apo burimi të ardhurash.
3. Të merrni kujdes të vëmendshëm dhe të respektueshëm në një ambient të pastër dhe të sigurt, pa kufizime të panevojshme.
4. Të merrni kujdes emergjent nëse e keni të nevojshme.
5. Të informoheni për emrin dhe pozicionin e doktorit përgjegjës për kujdesin tuaj në spital.
6. Të dini emrat, pozicionin dhe funksionin e personelit të përfshirë në trajtimin tuaj dhe të refuzoni trajtimin, ekzaminimin dhe vëzhgimin e tyre.
7. Të keni një dhomë ku ndalohet duhani.
8. Të merrni informacion të plotë në lidhje me diagnozën, trajtimin dhe prognozën tuaj.
9. Të merrni të gjithë informacionin që ju duhet për të aprovuar çdo procedurë trajtimi të propozuar. Ky informacion duhet të përfshijë rreziqet dhe benefitet e procedurës apo trajtimit.
10. Të merrni të gjithë informacionin që ju duhet për të aprovuar një urdhër për mos t'u kthyer në jetë. Ju gjithashtu keni të drejtë të caktoni një person tjetër që të japi aprovimin për ju, nëse jeni shumë i sëmurë për ta dhënë. Për informacion të mëtejshëm, ju lutem kërkoni një kopje të broshurës "Urdhrat e moskthimit në jetë" – Një Guidë për Pacientët dhe Familjet."
11. Të refuzoni trajtimin dhe t'ju thuhet se çfarë ndikimi mund të ketë në shëndetin tuaj.
12. Të refuzoni të merrni pjesë në studime. Teksa vendosni të merrni pjesë ose jo, keni të drejtë të merrni një shpjegim të plotë.
13. Të keni privatësi kur jeni në spital dhe konfidencialitet për të gjithë informacionin dhe kartelën lidhur me kujdesin tuaj shëndetësor.
14. Të merrni pjesë në të gjitha vendimet lidhur me trajtimin dhe daljen nga spitali. Spitali duhet t'ju sigurojë një plan të shkruar daljeje dhe një përshtkrim të shkruar sesi do të arrihet në fazën e daljes.
15. Të rishikoni kartelën mjekësore pa pagesë. Të merrni një kopje të kartelës kundrejt një pagese të arsyeshme. Nuk mund t'ju mohohet një kopje vetëm sepse nuk mund ta paguani.
16. Të merrni një faturë sipas trajtimeve dhe shërbimeve dhe shpjegime të të gjitha pagesave.
17. Të ankoheni pa frikë hakmarrjeje për kujdesin dhe shërbimet që po merrni, dhe spitali t'ju përgjigjet, dhe gjithashtu, nëse ju e kërkoni, një përgjigje të shkruar. Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen, mund ti drejtoheni Departamentit të Shëndetit të Shtetit të Nju Jorkut
18. Të autorizoni ata familjarë apo të tjerë të rritur që do t'ju jepet prioritet për vizitat në varësi të gjendjes tuaj për të pritur vizitorë.
19. Ti bëni të ditura dëshirat tuaja në lidhje me dhurimin e trupit pas vdekjes. Ju mund ti dokumentoni dëshirat tuaja në proxy-n tuaj mjekësor ose në një kartë dhurimi që ofrohet nga spitali.